

## Trajnim me temë të "Përdorimi i platformës Qualtrics; një mjet për hartimin e pyetësorëve" në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u zhvillua me sukses trajnimi me në fokus doktorantët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike.

Trajnimi me temë "Përdorimi i platformës Qualtrics; një mjet për hartimin e pyetësorëve" u zhvillua nga Dr. Merita Hoxha dhe kishte në fokus njohjen me rrjetin kërkimor ndërdisiplinor COST Association, si ai ndihmon kërkuesit shkencorë, hartimi i pyetësorëve përmes platformës Qualtrics, si edhe trajtoi aspekte teorike duke vënë theksin në këshilla dhe rekomandime të vlefshme për të pranishmit.

Trajnimi i zhvillua në bashkëpunim me COST Action 21114- CLIL Network for Languages in Education: Towards bi-and multilingual disciplinary literacies (CLILNetLE) dhe Dr. Craig Neville nga Kolegji Universitar Cork.



